



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 682/3 Prot.

Tiranë, më 21.05.2025

V E N D I M

Nr. 127, Datë 21.05.2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr.102 Regj., datë 24.04.2025 të z. R. M., kundër: Këshillit të Etikës të Universitetit të Sporteve; Prof.Asc.Dr. K. V.; Dekanatit dhe Rektoratit të Universitetit të Sporteve, në të cilën pretendoni diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*” dhe “*çdo shkak tjetër*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi shpjegon se: *Me anë të kësaj ankese me shkak ligjor të mbrojtur si më sipër cituar, konkretisht “për shkak të bindjeve politike”, si dhe shkakut “për çdo shkak tjetër”, që i referohet ankesës së ankuesit R. M., në Këshillin e Etikës së Universitetit të Sporteve Tiranë, ju referoj sa më poshtë vijon:*

Unë, ankuesi R. M., student në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes në Universitetin e Sporteve Tiranë, në vitin e tretë "Bachelor", kam pasur problematika me ish-Dekanin e Sporteve, z. Dh.P, pasi ndaj këtij të fundit kam ushtruar kallëzim penal dhe një sërë ankesash të tjera në organet e drejtësisë. Konkretisht, këtë shtetas e kam akuzuar për shpërdorim detyre, sipas nenit 248 të Kodit Penal, si dhe për veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës.

Në vijim, ju vëmë në dijeni se çështja penale ndaj këtij shtetasi ndodhet aktualisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi bazën e ankimit ushtruar nga ankuesi R. M.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Në vijim, kolegja e shtetasit të mësipërm, K. V., më diskriminonte për shkak të bindjeve të mia politike, pasi unë disa herë kam marrë pjesë në aktivitete kulturore dhe fetare të organizuara nga Kryetari në detyrë i Bashkisë Tiranë, z. E. V. Në këto veprimtari kulturore dhe fetare, ku unë kam marrë pjesë me ftesë të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ky i fundit më ka nxjerrë dy herë në portalin e tij zyrtar në faqet e rrjeteve sociale.

Pasi është vënë në dijeni nga një student i klasës ku ankuesi frekuenton, mbi sa më sipër, pra fakti që Kryetari i Bashkisë ka nxjerrë ankuesin në faqet e tij të rrjeteve sociale, subjekti K. V. më ka identifikuar me nofkën fillimisht “Lali Eri”, dhe më pas më ka thënë që, në respekt të kësaj “nofke” të sipërcituar, do ta evidentonte emrin tim në regjistrat zyrtarë me këtë nofkë.

Ju bëjmë me dije se pedagogia K. V. më ka “pagëzuar” me këtë nofkë që në vitin e parë të studimeve dhe sa herë paraqitesha në provime më thërriste: “He Lali Eri, erdhe?”. Sikurse dihet mediatikisht, ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë është iniciuar një proces penal nga organet kompetente për fushën e veprimtarisë së tij dhe konkretisht më datë 18.02.2025, ora 12:35 AM.

Për më shumë në lidhje me këtë ngjarje ju referojmë, bashkangjitur kësaj ankese zyrtare, edhe shkresën nr. 604 prot., datë 19.02.2025, drejtuar Dekanit të Sporteve dhe për dijeni Rektorit të Sporteve.

Në vijim, Dekani i Drejtësisë më ka komunikuar vendimin Nr. I, datë 19.03.2025, të Komisionit Disiplinor të FSHL, me shkresën nr. 604/5 prot., datë 20.03.2025, ku Komisioni i Etikës ka konkluduar që nuk ka shkelje nga ana e pedagoges K. V., referuar ankesës së ankuesit me nr. 604 prot., datë 19.02.2025. Kundër këtij vendimi të Komisionit Disiplinor, ankuesi ka ushtruar ankim përpara Rektorit, konkretisht me shkresën nr. 604/6 prot., datë 02.04.2025.

Ju vëmë në dijeni se vendimi i Komisionit Disiplinor, në lidhje me shqyrtimin e ankesës sime, më është komunikuar me shkresën e Dekanit të FSHL-së, nr. 604/5 prot., datë 20.03.2025. Ky vendim më është komunikuar ndërmjet datave 20.03.2025 – 25.03.2025. Pasi është komunikuar shkresa e mësipërme me anë të postës zyrtare, 3 ditë pas intervalit kohor (20–25.03.2025), më ka njoftuar sekretaria e universitetit, me telefon, për të tërhequr një tjetër dokument. Unë, ankuesi, mendova se ishte i njëjti dokument që më ka përcjellë me postë, duke besuar se mos ishte ndonjë dublikatë njoftimesh.

Pasi e mora dokumentin “e dytë”, konkretisht shkresën nr. 914/3 prot., datë 20.03.2025, me lëndë: “Përcjellje e shkresës nr. 817 prot., datë 11.03.2025, përpiluar nga Dekani i FSHL”, nuk rezulton e qartë në këtë shkresë që bëhej fjalë për një ankesë të drejtuar nga subjekti kundër të cilit drejtohet kjo ankesë, konkretisht znj. K. V., ndaj ankuesit R. M. Po ashtu, as në shkresën përcjellëse të ankesës së znj. K. V., konkretisht shkresa nr. 817 prot., datë 11.03.2025, nuk shquhet në titull që bëhet fjalë për një ankesë drejtuar Këshillit të Etikës nga ana e shtetas K. V., kjo e fundit, duke u fshehur pas shkronjave të ankesës së saj, në tentativë për t’i krijuar ankuesit R. M. “iluzionin/përshtypjen” që kjo shkresë (817/2025) është dërguar tek Komisioni i Disiplinës për t’i

nxjerrë ankuesit R. M., provat që ky i fundit mund të ketë si mjet mbrojtës kundrejt ankimimit të vendimit të Dekanit.

Kërkuesi u detyrua të ndjekë këtë lojë “të shëmtuar” procedurale duke ia mbajtur “ison” subjekteve të mësipërme. Dhe së fundmi, në finale, siç thotë populli, “Gjarpri e nxori kokën”, me shkresën nr. 1160/3 prot., datë 18.04.2025, të Këshillit të Etikës, me lëndë: “Njoftim mbi datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore”, pasi unë, ankuesi, “paskëkam” cenuar dinjitetin e zonjës K. V., dhe kjo shtetase, sikundër dokumentohet nga shkresa e përpiluar më datë 11.03.2025, “zgjohet/alarmohet” për të adresuar pretendimet e saj ndaj ankuesit, pikërisht dhe posaçërisht në momentin procedural kur ankuesi ka depozituar ankesën e tij në Këshillin e Etikës.

Të gjitha këto argumentime provohen pa ekuivokshmërisht pikërisht nga aktet që ankuesi do t’ia bashkëngjisë kësaj ankese zyrtare. Kjo lojë procedurale është bërë me qëllim që ankuesi të mos kishte të qartë se kjo shkresë kishte të bënte me një ankesë të shtetases K. V., ndaj ankuesit R. M., por të maskohej kjo shkresë si “përgjigje / parashtrime me shkrim” në kuadër të ankesës së ankuesit R. M., ndaj saj.

Përpos sa sipër, duke iu rikthyer edhe njëherë fakteve të mësipërme, Rektori i Universitetit, me shkresën nr. 604/9 prot., datë 11.04.2025, nuk ka konstatuar shkelje nga pedagogia në fjalë. Ndaj, për sa parashtruar, ju kërkoj që, në përputhje me ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, të nisë procedimi administrativ ndaj të gjithë subjekteve për diskriminim për shkak të bindjeve politike, si dhe për shkak të ankesës së ankuesit R. M., ndaj shtetases K. V., në Komisionin Disiplinor të FSHL-së.

Duke besuar në një hetim të thellë të kësaj çështjeje, kemi besim tek institucioni juaj. Bashkëngjitur gjendet i gjithë dokumentacioni provues që mbështet pretendimet e kësaj ankese.

I. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se ajo paraqiste mangësi të anës formale, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit “bindjet politike” dhe “çdo shkak tjetër”. Me qëllim plotësimin e mangësive të ankesës, me shkresën nr.682/1 prot., datë 30.04.2025.01.2023 “*Kërkesë për informacion*”, ankuesit iu kërkuar sa më poshtë:

- Shpjegime më të hollësishme në lidhje me shkaqet e pretenduara për diskriminim, duke përcaktuar qartë cila është karakteristika, apo veçantia që ju e mbartni dhe që prezumohet të ketë ndikuar në kryerjen e sjelljes diskriminuese. Ky informacion duhet të shoqërohet me fakte dhe prova konkrete që vërtetojnë se ju i mbartni këto shkaqe të pretenduara.
- Përveç përshkrimit të shkaqeve, është e nevojshme të sqarohet në mënyrë të qartë se si këto shkaqe kanë ndikuar drejtpërdrejt në trajtimin që ju konsideroni diskriminues. Ju lutemi të përshkruani lidhjen midis rrethanave të paraqitura dhe pasojave konkrete që keni përjetuar për shkak të tyre.

- Në ankesën tuaj, por dhe në formularin e ankesës, nuk keni dhënë datën e pretenduar të diskriminimit, por dhe as datën e marrjes dijeni të diskriminimit. Në këto kushte, është e domosdoshme që të saktësoni në mënyrë të qartë dhe të plotë datën, muajin dhe vitin kur ka ndodhur ngjarja që ju e konsideroni si akt diskriminues, si dhe datën kur jeni vënë në dijeni për këtë situatë.
- Informacion nëse, i keni adresuar shqetësimet për diskriminimin tek drejtuesit e Universitetit të Sporteve: nëse po, ju lutemi të na vini në dispozicion kopje e ankesës si dhe përgjigjen e kthyer nga institucioni.
- Kopje të ankesave/kallëzimit penal të përmendur në ankesën tuaj si dhe kopje të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
- Çdo informacion ose dokumentacion tjetër shtesë që ju do e gjykoni të nevojshëm në mbështetje të ankesës tuaj.

Në vijim me e-mail e datës 11.05.2025 u kthye përgjigje nga ana e ankuesit si mëposhtë vijon:

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 682 prot., datë 30.04.2025, ku na keni lënë detyra konkrete në lidhje me ankesën nr. 102 regj., datë 24.04.2025, ju citojmë sa më poshtë vijon:

Në lidhje me pikën 1:

Bashkëngjitur ankesës së subjektit ankues kemi bashkëngjitur prova dhe fakte konkrete që prezumojnë prima facie se kemi një diskriminim për shkak të shkakut politik. Ankuesi ka dalë në foto me Kryetarin e Bashkisë Tiranë, z. Erion Veliaj, fakt i cili është i ditur botërisht për shkak se ky subjekt politik i ka publikuar fotot në rrjetet e tij sociale. Në këtë kontekst, subjekti diskriminues K.V ka përdorur një gjuhë diskriminuese në universitet, konkretisht në klasë, duke e etiketuar subjektin ankues me nofkën “Lali Eri”. Thënë kjo, te subjekti ankues është krijuar dyshimi në dukje se, subjekti diskriminues po e disfavorizon dhe diskriminon ankuesin për shkak të faktit se ai ka dalë në një aktivitet publik me Kryetarin e Bashkisë Tiranë. Bashkëngjitur ankesës kemi depozituar edhe fakte dhe prova dokumentare që provojnë këtë fakt të dukshëm botërisht.

Në lidhje me pikën 2:

Për shkakun e mësipërm, subjekti ankues përgjatë tre viteve akademike është ofenduar dhe fyer rëndë nga subjekti diskriminues, për shkak të faktit se të tretët kanë krijuar perceptimin se subjekti ankues ka lidhje miqësore me një funksionar publik, duke lënë dyshime (tek të tretët) se ky favorizohet në mësim, ndërsa tek një pjesë tjetër krijohet urrejtje pasive (jo e fshehur) për shkak se, ndonëse shkolla është e depolitizuar, ka studentë të tjerë të cilët kanë konsiderata negative në raport me funksionarin publik të sipërpërmendur. Kurse disa të tjerë e konsiderojnë subjektin ankues si “klloun cirku”, duke e tallur dhe duke qeshur me të përgjatë gjithë orëve të mësimi. Pra, dukshëm veprimet e subjektit diskriminues kanë përforcuar këtë urrejtje dhe përçmim tallës që subjektit ankues i janë shkaktuar, për shkak se shtetasja K.V, dihet botërisht nga të gjithë studentët e Universitetit të Sporteve që e ka etiketuar me nofkën “Lali Eri”.

Në lidhje me pikën 3:

Komisioneri ka kërkuar kohën se kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar, si dhe kohën kur subjekti ankues ka marrë dijeni mbi këtë sjellje diskriminuese. Subjekti ankues është regjistruar në Universitetin e Sporteve në vitin akademik 2022–2023, kurse sjellja diskriminuese ka ndodhur për herë të parë në maj të vitit 2023, gjatë kohës që pedagogia K.V jepte lëndët “Dietologji” dhe “Shëndet Publik”. Gjatë apelit që ka bërë për herë të parë, subjekti diskriminues K.V e ka etiketuar për herë të parë me nofkën “Lali Eri”. Ky pretendim lidhet edhe me foton e bërë publike nga ana e funksionarit publik Erion Veliaj në rrjetin e tij social “Instagram”, që mban datën 10 prill 2023.

Nga ky moment e në vijim, sikurse kemi theksuar edhe në ankesë, subjekti diskriminues e ka damkosur subjektin ankues me nofkën “Lali Eri” si dhe duke i thënë herë pas here në sy të auditorit dhe në prani të studentëve të tjerë fjalët: “do të vendos një pikë në regjistër” (duke nënkuptuar identifikimin e subjektit ankues me nofkën “Lali Eri”). Këto prova dokumentare jua kemi përcjellë me email zyrtarisht, pra fotot publike të subjektit ankues me funksionarin publik z. Erion Veliaj, si dhe video e incizuar në mënyrë private nga subjekti ankues në auditor. Fundi i sjelljes diskriminuese ka qenë fakti i ndodhur më datë 18.02.2025, në orën e mësimi të lëndës “Testim Klinik”, lëndë e cila zhvillohet në vitin e tretë të programit “Bachelor” dhe jepet nga lektorja K.V.

Në lidhje me pikën 4:

Ju bëjmë me dije se pretendimin për diskriminim, subjekti ankues e ka ngritur edhe përpara Dekanit të Sporteve dhe përpara Rektorit të Universitetit. Në emaillet zyrtare që ju kemi përcjellë, ju kemi dërguar edhe kopje të ankesave të skanuara përpara autoriteteve të mësipërme universitare.

Në lidhje me pikën 5:

Në lidhje me kopje të ankesave dhe kallëzimit penal, si dhe vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ato do t’ju bashkëngjiten me email në vijim.

Në lidhje me pikën 6:

Ku keni kërkuar çdo informacion apo dokumentacion tjetër shtesë të nevojshëm dhe në mbështetje të ankesës së subjektit ankues, ju theksojmë se:

Me shkresën nr. 1160/3, datë 18.04.2025, subjekti ankues është njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të seancës dëgjimore nga Këshilli i Etikës, për të dhënë shpjegime në seancën e datës 25.04.2025, ora 10:00. Subjekti ankues është paraqitur së bashku me babain e tij, shtetasin A. M., dhe në orën 10:05 kemi hyrë në sallën “Meeting Room”.

Shtetasi A. M., kërkoi para trupit të Këshillit të Etikës që të legjitimohej në proces në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshëm të subjektit ankues. Anëtarët e Këshillit të Etikës, me

intonacion arrogant dhe fytes, e kanë urdhëruar shtetasin A. M., të dalë jashtë, kurse subjektin ankues ta lejonin të hynte dhe të ulej. Ndërkohë, shtetasi A. M., i ka kërkuar Këshillit që të qëndronte si dëgjues, meqenëse seanca dëgjimore mbahej me procesverbal audio. Sërish, Këshilli i Etikës nuk e ka lejuar qëndrimin e babait të subjektit ankues as në cilësinë e dëgjuesit.

Subjekti ankues i ka kërkuar Këshillit që të bënte një deklaratë noteriale ku të merrte përsipër përfaqësimin e tij, por as këtë herë nuk është lejuar për shkak të faktit se subjekti ankues ishte i rritur dhe “votonte vetë”. Ndërkohë e kanë pyetur subjektin ankues: “Voton ti, voton?”.

Shtetasi A.M., i ka pyetur anëtarët e këshillit nëse seanca dëgjimore regjistrohej. Ata janë përgjigjur: “Ndoshta”. Ai ka pyetur më tej nëse, në rast se regjistrohej, do të vihej në dispozicion një kopje e procesverbalit audio. Sërish, anëtarët e këshillit janë përgjigjur shkurt me togfjalëshin: “Ndoshta”.

Në vijim, shtetasi A. M. i ka kërkuar subjektin ankues R. M., (djalit) të largohet nga salla, për shkak të abuzimit nga ana e anëtarëve të Këshillit të Etikës mbi procedurën dhe rregullat statutores të procedimit administrativ disiplinor të nisur ndaj tij.

Në vijim, subjekti ankues me babain e tij, shtetasin A. M., janë paraqitur përpara Dekanit të Universitetit me qëllim për t’u ankuar. Këtë bisedë që është zhvilluar me Dekanin, ai e mban mend shumë mirë dhe është i gatshëm ta riprodhojë në çdo moment, ashtu siç ka ndodhur dhe është folur verbalisht mes tyre.

Me shkresën nr. 1282/2, datë 08.05.2025, subjektin ankues i është komunikuar vendimi i Këshillit të Etikës, ku është vendosur:

- 1. Vlerësimi “shkelje e rëndë” të veprimeve të kryera nga studenti R. M., referuar Statutit dhe Rregullores së UST dhe Rregullores së Këshillit të Etikës;*
- 2. Marrja e masës disiplinore “vërejtje me shkrim” ndaj studentit R. M.*

Ju theksojmë se, sikurse u përshkrua më sipër, nuk kuptohet shkakut dhe rrethanat e marrjes së këtij vendimi, pasi ky vendim nuk shoqërohet me asnjë relacion në lidhje me shkeljet e pretenduara, mjetet e provës dhe provat e administruara në proces, mënyra dhe vlerësimi i fakteve, etj., duke cenuar rëndë të drejtën për një proces të rregullt ligjor dhe të drejtën e ankimit. Kjo përforcohet edhe nga fakti se shkresa nuk përmend të drejtën e ankimit në një instancë më të lartë, por është mjaftuar me togfjalëshin: “Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”.

Në përmbyllje, kërkojmë konstatimin e shkeljeve dhe diskriminimit për shkakun/et e përmendur në ankesë. Bashkëngjitur do t’ju përcjellim të gjithë dokumentacionin shkresor që keni kërkuar.

Sa më sipër, rezultoi se nga ana e ankuesit nuk ishte dërguar i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar dhe për këtë arsye me e-mail e datës 13.05.2025 iu kërkuar të dërgohej ky informacion për të mundësuar plotësimin e ankesës.

Në vijim të komunikimeve të mësipërme, ankuesi ktheu përgjigje me email e datës 14.05.2025, duke dhënë të njëjtat argumenta si në përgjigjet e mëparshme.

Në nenin 1 të ligjit nr. 1021/2010, i ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji *“Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si *“çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrotjtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “b” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrotjtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse:b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”*, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”*, si dhe *“ Vetëm në raste përjashtimore dhe*

për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr.39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Ligji Nr. 10 221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të moshës, të pretenduar nga ankuesi, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Sipas ligjit, diskriminimi mund të shfaqet në disa forma, ndër të cilat, në formën e “*Diskriminimit i drejtëpërdrejtë*”, e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji (neni 3/2) ose në formën e “*Diskriminimit të tërthortë*” e cila është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup

personash në kushte më pak të favorshme për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (neni 3/7). Ndërkohë, sipas nenit 6, të ligjit, trajtimi i ndryshëm është i përligjur dhe ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përrjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se, shkakun e pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një, nga shkaqet e mbrojtura, duhet të provojë ekzistencën e shkakut/shkaqeve të pretenduara të diskriminimit dhe të parashtrorë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtur/a.

Ankuesi, R. M., në ankesën e tij ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë diskriminuese për shkak të bindjeve të tij politike, pasi është etiketuar dhe tallur në mënyrë të përsëritur nga pedagogia K. V., me nofkën “Lali Eri”, pas publikimit të disa fotografive të tij në faqet zyrtare të rrjetit social instagram të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. E. V. Ai shprehet se kjo sjellje e përsëritur i ka shkaktuar një gjendje të rënduar psikologjike dhe përcëim nga bashkëstudentët, duke ndikuar negativisht në ambientin e tij akademik dhe dinjitetin personal.

Në radhë të parë, Komisioneri konstaton se, shkakun e bindjeve politike, i pretenduar nga ankuesi, është një shkak i cili gëzon mbrojtje në mënyrë të shprehur nga neni 1, i LMD. Në lidhje me provueshmërinë e shkakut, konstatohet se:

Për të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit “bindjet politike”, nga ana e ankuesit është depozituar pranë Komisionerit në cilësinë e provës fotot të ankuesit me Kryetarin e Bashkisë Tiranë, z. E. V., të publikuara në rrjetin social instagram të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, z. E. V.

Ankuesi nuk ka paraqitur asnjë dëshmi zyrtare që vërteton anëtarësinë apo përfshirjen e tij në një subjekt politik të regjistruar në Republikën e Shqipërisë, çka është një kusht i domosdoshëm për të provuar bindjen politike si bazë e mbrojtur nga ligji. Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 dhe nenin 3, e përfshin bindjen politike si një shkak të mbrojtur, por kjo kërkon që ankuesi të vërtetojë se është bartës i kësaj bindjeje përmes dokumentacionit ose veprimtarisë të dokumentuar dhe të identifikueshme. Thjesht pjesëmarrja në një aktivitet kulturor/fetar me një funksionar publik nuk përbën provë të mjaftueshme për të provuar diskriminimin mbi këtë bazë.

Komisioneri, megjithatë, konstaton se për të vërtetuar një rast diskriminimi mbi këtë bazë, duhet të ekzistojë provë e qartë që dëshmon bindjet politike të ankuesit si dhe një lidhje shkak-pasojë ndërmjet këtyre bindjeve dhe sjelljes së pretenduar diskriminuese. Në këtë rast, ankuesi nuk ka paraqitur asnjë provë dokumentare për përkatësi politike, as ndonjë provë që të tregojë se pedagogia në fjalë kishte qëndrime të kundërta politike. Fotot me një figurë publike nuk përbëjnë provë të mjaftueshme, pasi nuk janë dokumente zyrtare dhe nuk provojnë automatikisht identitetin politik të një individi.

Gjithashtu, nuk është paraqitur asnjë provë objektive apo dokumentacion që të dëshmojë qartë se pedagogia e përmendur, znj. K. V., ka shfaqur publikisht ose në mënyrë të njohur ndonjë qëndrim politik të kundërt me atë të pretenduar nga ankuesi. Kjo mungesë provash çon në pamundësinë për të ndërtuar një raport shkakësor të qëndrueshëm juridik ndërmjet bindjes së pretenduar të ankuesit dhe sjelljes së pretenduar diskriminuese të palës tjetër.

Pretendimi për diskriminim për shkak të bindjeve politike nuk gjen mbështetje të mjaftueshme ligjore për sa kohë mungojnë:

- Provat që dëshmojnë bindjen politike të ankuesit;
- Provat që dëshmojnë bindjet e kundërta të subjektit kundër të cilit është bërë ankesa;
- Një lidhje shkak-pasojë ndërmjet sjelljes së pretenduar dhe bindjes politike.
- Nuk ekziston asnjë provë apo fakt i dokumentuar që të vërtetojë sjellje diskriminuese konkrete nga ana e pedagoges ndaj ankuesit, në funksion të pretendimeve të ngritura.
- Pamjet fotografike në rrjete sociale nuk mund të vlerësohen si akte apo prova zyrtare, në mungesë të një vërtetimit, me datë të saktë dhe autenticitetit nga një burim zyrtar.

Sa më sipër, pavarësisht se shkakun e pretenduar të diskriminimit “bindja politike”, është një shkak që gëzon mbrojtje nga LMD, ankuesi nuk paraqiti fakte dhe prova për të provuar pretendimin e tij.

Ndërkohë z. R. M., në ankesën e tij ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe për shkak të “çdo shkakut tjetër”.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “çdo shkak tjetër” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “çdo shkak tjetër” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “shkakun” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “çdo shkak tjetër”. Rezulton se, për të patur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i ankuesit se është diskriminuar “për çdo shkak tjetër” pa identifikuar asnjë shkak konkret, i cili më pas të vlerësohet nga ana e Komisionerit nëse përbën ose jo një shkak që gëzon mbrojtje, nuk përbën një pretendim për diskriminim, sipas parashikimeve të LMD-së, dhe për rrjedhojë ankesa e paraqitur është e papajtueshme me dispozitat e LMD.

Gjithashtu, në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa e ankuesit, z. R. M., nuk është e mbështetur me dokumentacion administrativ zyrtar të justifikuar, në përputhje me kërkesat e ligjit dhe të formave të duhur ligjore për të vërtetuar pretendimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike. Po ashtu, për sa i përket pretendimit për diskriminim “për çdo shkak tjetër”, ky shkak mbetet i paqartë dhe i paidentifikuar në mënyrë të saktë.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk përmbush kriteret ligjore për të vërtetuar diskriminimin mbi bazën e bindjeve politike apo ndonjë shkakut tjetër të mbrojtur nga ligji. Mungesa e provave konkrete që vërtetojnë përkatësinë politike të ankuesit, si dhe mungesa e lidhjes së drejtpërdrejtë mes sjelljes së pedagoges dhe këtij pretendimi, e bëjnë të paqëndrueshëm juridikisht pretendimin e z. M. Edhe për sa i përket pretendimit të diskriminimit “për çdo shkak tjetër”, ky mbetet i papërcaktuar dhe i paidentifikuar në mënyrë të saktë nga ana e ankuesit, duke e bërë të pamundur vlerësimin nëse bëhet fjalë për një shkak që gëzon mbrojtje sipas legjislacionit në fuqi.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, gjithë sa më sipër dhe bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nr. 102 datë 24.11.2025, e paraqitur nga ankuesi z. R. M., kundër Këshillit të Etikës të Universitetit të Sporteve; Prof.Asc.Dr. K. V.; Dekanatit dhe Rektoratit të Universitetit të Sporteve, në të cilën pretendoni diskriminim për shkak të “bindjeve politike” dhe “çdo shkak tjetër”, nuk mund të pranohet, pasi është e papajtueshme me dispozitat e ligjit dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr.102, datë 24.04.2022, të paraqitur nga ankuesi z. R. M., pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: L. Jani
Miratoi: V. Bushati
Datë: 20.05.2024